



QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

Studim: “Ndikimi i mbajtjes së kurorës në kultivarët autokton (Pulëz dhe Karkanjoz)”.

(Vitet e studimit: 2017-2019).

1. Hyrje

Nisur nga kërkesat për treg, konsum i freskët rrushi, për përpunim industrial (konjak, vere, raki, likerna etj), apo dhe eksport, rritet nevoja për tu marrë me kulturën e hardhisë. Në këtë kuadër për t'ju përgjigjur krëkesave të tanishme nevojitet jo vetëm shtimi i sipërfaqeve të kultivuara e përmirësimit të tyre por njëkohësisht edhe rritja e aftësive prodhuese e konkurruese të kultivarëve autoktonë në raport me të tjerët.

Dy kultivarët autokton Pulës dhe Karkanjoz japin prodhime me vlera të larta teknologjike. Por, në kushtet e thatësisrës së gjatë verore dhe diversitetit të nivelit të fermave dhe fermereve për zbatimin e masave agroteknike këta dy kultivare në ekonomitë ku kultivohen sistemi i mbajtjes së kurorës mund të jetë një faktor për përmirësimin e gjendjes së vreshtave në nivel fermeri. Dy format, më të aplikuara për dy tipe krasitje të gjatë dhe të shkurtër atë të tipit Kordon Roaja dhe Gyo të një dhe të dy anshme.

Vendi : Studimi u ngrit në bazën Shamogjin të QTTB Vlorë.

Stafi i studimit: Llambro Dhima & Dr.Adhurim Lazaj, Ramo Merkohitaj, Xhek Mukaj

2. Materiali dhe metoda e përdorur

Studimi u ngrit në formën e provave në bazën e Shamogjin të QTTB, në kulturën e hardhisë në kultivarët Pulëz dhe Karkanjoz të shartuara mbi të njëjtën nënshartesë (SO4) me të cilat ka afinitet të mirë në koleksionin e vreshtit , të mbjellë në vitin 2014, në distancat 2,4x1,4 m.

Parcela ku u ngrit studimi shtrihet në kundrejtim Veri - Jug, me një sipërfaqe rreth 0.1 ha nga 0.3 ha të kultivuar me këto lloje. Toka është subargjilore , e mesme , me taban të thellë, dhe e përshkueshme nga uji, me ujëra freatike nën 1m .

Studimi u ngrit në formën e provave

Prova e parë; Kordon Roaja të nëanshme

Prova e dytë; Gyo e njëanshme

Për çdo provë do të merren në studim nga 30 bimë.

Treguesit e marrë në studim:

1. Numri i sythave dimërore të çelur.
2. Numri i lastarëve të zhvilluar prej sythave dimërore.
3. Numri i lastarëve frutore në raport me lastarët e zhvilluar.
4. Struktura prodhuese e lastarëve frutore. a) Numri i lastarëve frutore me një lulëri. b) Numri i lastarëve frutorë me dy lulëri. c) Numri i lastarëve frutore me tre lulëri e lart.
5. Koeficientët e prodhueshmërisë : a) absolute b) relative.
6. Numri i veshuleve të vjelë për një hardhi.
7. Peshat mesatare e një veshuli në gram.

8. Indekset e prodhueshmërisë : a) absolute ,b) relative. 9. Prodhimi i vjelë në kg/rrënjë dhe kv/ha. 10. Ndërtimi mekanik i vreshtit .11. Analizat kimike të rrushit (sheqer,aciditet), Shërbimet e tjera, si lidhjet, t' hartjet, prerjet, pincimet, unazimet, heqja e lastarëve në cung, heqja e rrënjëve mitake , etj., u kryhen në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë pa patur ndryshime e dallime.

3. Rezultate dhe diskutime

Formimi i kurorës **Roaya e njëanshme**: Kjo formë bën pjesë në grupin e kordonëve, por këtu u zbatua krasitja e shkurtër me çepa të shtrirë në gjatësi të kordonit. Për formimin e saj u veprua kështu në vazhdimësi të viteve:


Në vitin e parë: U veprua me synim që nga të dy sythat e lenë për rritje, ai më i dobëti pincohet në 4 gjethe, lastari tjetër lidhet që të rritet lirshëm dhe vertikalisht.

Në vitin e dytë: Nga dega e rritur vitin e parë , u zgjodh më e mira dhe u shkurtua në telin e parë, në 40-70 cm lartësi. Nga lastarët që dolën ku kordoni ishte me të dy krahët, u pre njëri prej tyre dhe u shtri në tel. Shtrirja u bë për të gjitha bimët nga njëri krah.


Në vitin e tretë: Sharmenda pritet në gjysmën e gjatësisë me syth nga poshtë që të çelin tërë sythat e lenë në gjatësi të sharmendës . Pas çeljes lastarët e rinj zgjidhen e rrallohen në largësi 20-25 cm larg njëri-tjetrit, mbi të cilët do të formohen hallkat e prodhimit.Lastarin e majës e lemë për rritje të lirshme për zgjatjen e kordonit në rastin kur nuk është arritur gjatësia e kordonit. Në rastin kur është arritur gjatësia e kordonit sharmendat e lena krasiten mbi 1-2 sytha për formimin e çepave së bashku me sharmendën e majës.

Në vitin e katërt: Do te përsëritet kjo krasitje derisa të formohët kordoni.

Në vitet në vazhdim: Kryhet krasitja prodhuese. Në çepat e hallkave prodhuese sharmendat shkurtohen me 1-2 sytha, zgjidhet lastari që është më afër bazës, në mënyrë alternative çdo vit.



Figurë 1. Forma Kordon roaja para dhe pas krasitjes



Figurë 2;3. Forma Gyo e njëanëshme në prodhim Forma Gyo e njëanshme pas krasitjes

Kjo formë bën pjesë në format e krasitjes së përzier, është nga më të njohurat dhe të përdorshme sidomos për kultivimet autoktonë të Karkanjozës dhe Pulës që nga çepi i shkurtër që lemë në rritje lastarë për prodhimin e vitit të ardhshëm dhe një sharmendë të gjatë me deri në 16 sytha.

Në vitin i parë: Ishte vepruar me synim që nga të dy sythat e lenë për rritje, ai më i dobëti pincohet në 4 gjethe, lastari tjetër lidhet që të rritet lirshëm dhe vertikalisht.

Në vitin e dytë: Lastarin më të mirë e shtrijmë në lartësinë e telit të parë duke i lenë 3-4 sytha nga të cilët mërret prodhim qysh këtë vit.

Në vitin e tretë: Nga sharmendat e rritura, ai që është më afër trupit u krasit 2 sytha dhe do të shërbejë si çep zëvendësimi për vitin tjetër, ndërsa sharmenda tjetër u krasit me deri në 16 sytha.

Në vitin e katër: Do të vazhdohet me krasitjen prodhuese, duke bërë alternimin e çep – sharmendë ku do të pritet sharmenda dhe do të lihet çepi ku çelin lastarët, ku i bazës lihet si çep dhe ai i sipërmi lihet si sharmendë në ngarkesën që cituam si më sipër.

Në vitet në vazhdim: Bëhet krasitja prodhuese, ku lastari i bazës shërben si çep zëvendësues dhe lastari i sipërm lihet si sharmendë prodhuese, në mënyrë alternative për çdo vit.

Rezultatet dolën nga përpunimi dhe përshkrimi i vrojtimeve e të dhënave si dhe analizë statistikore të tyre duke u mbështetur në këtë metodikë e duke paraqitur tabelat dhe grafikët perkates sipas treguesve që parashikohen. Gjatë aplikimit (eksperimentit) u ndoqën këta tregues:

1. Nga kërkimi i bërë në QTTB Vlorë rezultoi se duke i krahasuar të dhënat e prodhimit sipas varianteve dhe përsëritjeve për secilin kultivar **nuk ka ndryshime** në vitin e parë të kërimit. Kërkimi do të vazhdojë edhe dy vite të tjera.

a. Të dhënat agrobiologjike

Tabelë 1 Ndikimi i krasitjeve në elementët e prodhueshmërisë biologjike të kultivarëve Karkanjoz dhe Pulës, që për çdo variant e përsëritje u analizua sipas tabelës (Në fletoren e shënimeve):

Varianti	Përsëritja	Nr. i Bllokut	Nr. i Bimës në Rrjesht	Rreshti nr.	Nr. i bimës në Studim	Ngarkesa në Sytha /Bimë	Nr i Sythave të çelur /Bimë	Lastarë të zhvilluar	Lastarë frutore	Struktura e Lastarit frutor			Nr. gjithësejt i lulesave	Lastarë të lenë /bimë	Koefficienti i prodhimitaris	
										- Me 1 lulesë	- Me 2 lulesa	- Me 3 lulesa			Absolut	Relativ



Figurë 4. Nga puna në cv.Pulëz dhe Karkanjoz

b. Të dhënat e prodhimit

Tabelë 2. Ndikimi i krasitjeve në prodhueshmërinë e kultivarëve Karkanjoz dhe Pulës që për çdo prove i treguesve që u analizuan, sipas tabelës (Në fletoren e shënimeve):

Varianti	Përsëritja	Nr.i Bllokut	Nr. i Bimës në Rrjesht	Rreshhti nr.	Nr. i bimes ne Studim	Nr. Gjithesajt i veshuleve ne vjelje	Pesha mesatare e nje veshuli ne gr.	Prodhimi i vjele ne Kg/rrenje	Rendimenti Kv/ha	Permbajtja e sheqerit %	Permbajtja e aciditetit %	Indeksi i prodhueshmëri së	
												Absolut	Relativ

➤ Analizat e kryera (grafikë dhe komente):

a.**Përqindja e sheqerit dhe aciditetit** (mesatarja në laboratorin e QTTB Vlorë), nga ku rezultoi: Variantet e përsëritjet për cv.Pulës përkatësisht 22.85 % sheqer dhe 4.85 gr./l aciditet dhe për cv.Karkanjoz përkatësisht 19.85% sheqer dhe 5.15 gr./l aciditet. Lënda e that 74 % te cv.Pulës dhe 75 % te cv.Karkanjoz.

b.1 Rezultatet e treguesve të prodhimit

Tabelë 3. Të dhënat e treguesve të prodhimit për kultivarin Karkanjoz.

Nr	Varianti	Sytha të çelur	Nr.gj. i Lulerive	Nr. i Lestarë të lënë	Nr. i Veshulë në vjelje	Pesha mes. e 1 veshuli në gr.	Prodhimi i vjelë në kg/rrënj	Rendimenti kv/ha
		Mes±Mes. Gab.Std	Mes±Mes. Gab.Std	Mes±Mes. Gab.Std	Mes±Mes. Gab.Std	Mes±Mes. Gab.Std	Mes±Mes. Gab.Std	Mes±Mes. Gab.Std

1	Prova 1	14.6±0.50	21.4±1.86	4.2±0.20	7.40±0.24	499.0±14.86	3.69±0.19	134.07±0.19
2	Prova 1	14.2±0.80	19.0±0.94	4.0±0.00	7.80±0.20	503.2±17.16	3.93±0.21	142.72±0.21
3	Prova 1	14.6±0.81	19.0±2.40	4.0±0.00	7.40±0.24	435.6±11.03	3.22±0.17	117.08±0.17
4	Prova 2	15.8±0.96	18.0±1.67	4.4±0.24	7.80±0.20	490.0±17.74	3.83±0.22	139.04±0.22
5	Prova 2	14.6±0.92	15.0±1.18	4.2±0.20	7.60±0.24	474.4±21.96	3.62±0.26	131.25±0.26
6	Prova 2	16.6±1.56	19.0±1.67	4.0±0.00	7.60±0.24	479.6±22.47	3.65±0.25	132.58±0.25

b.1.1. Rezultatet e treguesve të prodhimit

Tabelë 4. Të dhënat e treguesve të prodhimit për kultivarin Pulëz.

➤ **Efektiviteti ekonomik:** Nuk ka diferenca në shpenzime pasi është viti i parë i studimit.

Nr	Varianti	Sytha të çelur	Nr.gj. i Lulerive	Nr. i Lastarë të lënë	Nr. i Veshulë në vjelje	Pesha mes. e 1 veshuli në gr.	Prodhimi i vjelë në kg/rrënj	Rendimenti kv/ha
		Mes±Mes. Gab.Std	Mes±Mes. Gab.Std	Mes±Mes. Gab.Std	Mes±Mes. Gab.Std	Mes±Mes. Gab.Std	Mes±Mes. Gab.Std	Mes±Mes. Gab.Std
1	Prova 1	19.8±1.98	20.8±2.01	4.4±0.24	7.4±0.24	336.6± 5.90	2.49±0.12	90.46±4.41
2	Prova 1	23.2±1.15	16.8±1.01	4.2±0.20	7.6±0.24	335.2±12.92	2.55±0.17	92.76±6.28
3	Prova 1	20.4±1.80	18.2±0.96	4.2±0.20	7.6±0.24	344.2± 8.35	2.62±0.14	95.12 ±5.28
4	Prova 2	19.4±1.50	17.4±1.20	4.4±0.24	8.0 ±0.00	343.0± 1.70	2.74±0.01	99.47 ±0.49
5	Prova 2	21.2±1.01	19.0±1.41	4.2±0.20	7.2±0.20	330.2± 4.56	2.38±0.09	86.27±3.40
6	Prova 2	19.8±1.39	18.2±2.16	4.4±0.24	7.8±0.20	351.4± 3.98	2.74±0.09	99.45±3.47

Ndryshimet do të pasqyrohen vitet në vazhdim.

- **Përgatitja e mesazheve për fermerin, komente:** Në kohën e krasitjes, për fermerët mund të organizohet një demonstrim për format e mbajtjes së bimës.
- **Konkluzionet e studimit:** Për arsye se është viti i parë në formimin e kurorave të tyre, nuk vërehen ndryshime në prova për rezultatin që presim. Rezultat do të ketë dy vitet në vazhdim.
- **Trajnime, demonstrime, temë trajnimi (lidhur me studimin), foto nga puna e bërë për këtë studim:** Gjatë viteve në vijim do të kryhen tema e trajnime të këtij studimi si dhe paraqitje të fletpalosjeve, foto, etj.,

4. Literatura

1. P.Sotiri, T.Gjermani, T.Nini : Viticultura 1973.
2. M.Pelingi,V.Abazi : Për një vreshtari intensive e rentabile/: “Kalimi në forma kordoni” (Bujq.Soc. 2/1973)
3. P.Sotiri : Ndikimi i krasitjeve mbi llojin e rrushit “Mavrud”, Bul.Shkenc.Bujqës. Nr. 1 / 1976.
4. P.Sotiri : Krasitja, prodhimi dhe cilesia tek lloji i rrushit “Sheshi i Bardhe”, Bul.Shkenc.Bujq. Nr.1/ 4 / 1976.
5. V.Abazi : Krasitjet e hardhisë , (Shtëpia Botuese “Globus R” Tiranë , 1995.
6. H.Fiku : Raport përfundimtar i kërkimit në fermë : “Format optimal të krasitjes së vreshtave në kultivarët e hershëm për tryezë”, Botim i Q.T.T.B. Vlorë , viti 2011.

Specialist:

Llambro Dhima